FJALORI I FJALËVE TË RRALLA KRUTANE, MBLEDHUR NGA ILIR GOCI







Fjalori i fjalëve të rralla krutane

Mbledhur nga Ilir Goci

Të dashur pjesëmarrës!

Pjesëmarrja ime në këtë aktivitet është një moment shumë emocional, sepse më rikthen në vitet e rinisë sime, të cilat lidhen me aktin e lejimit tim për të vazhduar studimet e larta në Institutin e Lartë të Arteve në Tiranë. Më pas, më kujtohen vitet e punës në Shtëpinë e Kulturës në Borizanë, nga viti 1975–1983, dhe më vonë në Pallatin e Kulturës në Laç, kur ky qytet ishte pjesë e rrethit të Krujës, deri në vitin 1992.

Me këtë rast, më lejoni të bëj një homazh për shumë prej miqve të mi krutanë, disa prej të cilëve nuk jetojnë më. Më së pari, dua të nderoj artistin krutan, emrin e të cilit mban ky

institucion — regjisorin, autorin dhe frymëzuesin e shumë aktiviteteve të organizuara përgjatë dekadave, përfshirë dramën *Skënderbeu* dhe regjinë e Festivaleve të Gjirokastrës — të ndjerin Brahim Berdaku. Nderim dhe respekt.

Po ashtu, dua të kujtoj artistë si artistin e madh të popullit, Ramiz Kovaci; muzikantë si Latif Nuna, tani i ndjerë, dhe të birin, Agim Nuna; vëllezërit Met dhe Agim Darova; Skënder Rekën; ish-drejtorin e Shtëpisë së Kulturës, Cen Llubani, etj.

Dua të kujtoj piktorët Matish Staka,Ismail Berdaku dhe Petrit Roshi; artistët Medi Guni, Qamil Qoshja, muzikantin Bashkim Rama, Adelina Hoxha, Vogwl Malkuci, këngëtaren Dëshirë Maja–Mustafaj; aktorin e humorit Rrem Loci; dhe shkrimtarin Hamdi Meca.

Dua të kujtoj themeluesin e Grupit të Pleqve dhe ish-drejtorin tim në Borizanë, z. Fadil Taga, sot në një moshë të thyer dhe me banim në Itali, për të cilin ruaj një respekt të veçantë.

Me këtë rast, më lejoni të përmend me respekt të veçantë artistin krutan Met Llubanin, i cili vazhdon të mbajë gjallë traditën e mrekullueshme të Grupit të Pleqve të këtij qyteti me emër të madh historik dhe bashkëkohor.

SI U NJOHA ME GJUHËN DIALEKTORE KRUTANE?

Më 24 shtator 1966, në një mbrëmje të qetë vjeshte, në një peizazh të mrekullueshëm të mbushur me pemë e gështenja, në një shtëpi që rrinte si në prehërin e një kodre me ujë të bollshëm e bereqet, u shfaq papritur një

makinë e Sigurimit të Shtetit. Na morën me forcë dhe na nisën për në një vend që nuk e kishim dëgjuar kurrë më parë. Të nesërmen, siç ishim nisur, mbërritëm trembëdhjetë vetë: shtatë gra dhe pesë meshkuj të familjes sonë.

Historia e vendosjes sonë atje është e gjatë, por unë dua të ndalem tek gjuha e atij fshati me emrin sa të çuditshëm, aq të paharrueshëm: Shpërdhet. Emër më të habitshëm nuk kisha dëgjuar. Pasi na strehoi për sevap dervishi i fshatit - shpirti i bëftë dritë Zenel Dervishit - të nesërmen dolëm në rrugën e lagjes. Banorët, kureshtarë tej mase që në fshatin e tyre ishin shfaqur disa jabanxhinj, ndoshta për herë të parë në historinë e tyre, na dolën përpara të habitur dhe na pyetën:

“A ke shpaj e Z’nelit? Keni erdh me ndejtë ju re?”

Ne, që flisnim një dialekt të fortë gegë nga veriu, nuk morëm vesh asnjë fjalë nga ai dialekt. I pyetëm sërish se çfarë donin të thoshin, por pa sukses. Të hutuar, u kthyem në shtëpi.

Këtë episod ma risolli gjallë në mendje libri i Ilir Gocit ***“Fjalë Kruje Thesare”*.**
Puna e Ilir Gocit nuk nis në një terren të zbrazët. Ai është biri i historianit të mirënjohur krutan, mbledhësit të rrëfimeve, ngjarjeve, gojëdhënave dhe folklorit të këtyre anëve.

E kisha mik dhe e vlerësoja shumë atë burrë të rrallë krutan. E kam ndjekur jo pak herë teksa referonte tema historike në aktivitetet që, në vitet ’70 të shekullit të kaluar,

organizoheshin në salla si ajo e Shtëpisë së Kulturës në Krujë, në Borizanë dhe në shumë mjedise të tjera.

Statura e tij - burrë i pashëm, me syze të trasha optike - më krijonte gjithmonë një ndjesi të këndshme kur e dëgjoja: plot dije, argumente dhe, mbi të gjitha, me një dashuri të jashtëzakonshme për historinë e Krujës, e cila ruan aq shumë gurë të çmuar në mozaikun e saj.

Dhe ja, sot na vjen me një libër interesant edhe Iliri, i biri i profesorit të nderuar Haxhi Goci, ose Xhiu, siç e thërrisnim me përkëdheli në atë kohë.
Libri i tij i sapobotuar, me rreth 700 fjalë të rralla të të folmes së përditshme krutane, është një punë me vlerë të madhe dhe një

kontribut i rëndësishëm për ruajtjen e këtij thesari gjuhësor.

E shfletova librin dhe shumë nga ato fjalë i kisha dëgjuar gjatë viteve të punës sime në Borizanë dhe në aktivitetet në Krujë. Është për t'u habitur se si ato fjalë nuk njiheshin fare nga banorët që jetonin vetëm disa kilometra më tej, si në Thumanë, Mamurras, Laç apo Milot, sidomos në radhët e banorëve të ardhur, siç isha edhe unë.

Sigurisht që për një krutan ose banor të kësaj treve që flet gjuhën, fjalët e së cilës i ka mbledhur me aq përkujdesje Ilir Goci, këto shprehje janë të natyrshme.

A do ta kuptonte vallë një krutan në atë kohë, nëse unë do t'i këndoja këngën e mëposhtme?

N'drras t'vekit kush po kan?

Kan syzeza për jaran.

Bar e dushk në bjeshkë po i than

S'po len verë sivjet me dalë.

Në të vërtetë, një autor amerikan të cilin unë e kam shumë për zemër, Charles Telford Erickson, në veprën e tij ***"Shqiptarët – Enigma e Ballkanit",*** *thotë:*

"Është e çuditshme se si një shqiptar nga Korça, i cili kurrë në jetën e vet nuk ka vajtur në Tiranë, madje kurrë nuk ka takuar një shqiptar nga veriu, edhe pse kanë vështirësi të merren vesh me njëri-tjetrin, prapësepraprë flasin të njëjtën gjuhë — atë shqipe."

Unë nuk jam studiues i linguistikës, por natyrisht që më është dhënë mundësia të dëgjoj tërë dialektet e shqipes dhe t'i kuptoj ato. Në ato vitet që përmenda, kur dëgjoja

Haxhi Gocin, Kolec Topallin dhe studiues të tjerë krutanë ose jabanxhinj në rrethin e Krujës, i shihja me shumë simpati dhe kureshtje.

TANI ERDHI KOHA TË NDALEMI TEK LIBRI I ILIR GOCIT.

Unë dua ta komplimentoj Ilirin për punën e kujdesshme, mbledhëse si një bletë; për renditjen alfabetike; shpjegimet e thjeshta të kuptimit të fjalëve; botimin dhe promovimin e tij sot.

*Midis 700 fjalëve të mbledhura, unë zgjodha 36 prej tyre — aq sa ka gërma gjuha shqipe, që nga **A-ja** deri tek **Zh-ja** — dhe pikërisht…*

A–Zh: Fjalët e përzgjedhura

AZLLAJ – hije

BADOL – trupmadh

CICU – ngacmoj për një punë ose diçka tjetër që të bëhet më shpejt

ÇORE – thashetheme

DELENAJS – turpëruar publikisht

DHIMES – dhimbsur

FLIRAC – pa shumë mund; peshë e lehtë. Shembull: *filani asht flirac për mend*...

GLEDHE – përkëdhelje

GJYRDOP – rrugë qorre

HASHNURLLAJK – punë e bërë me qejf e me gjithë shpirt. Shembull: *e bani me shumë hashnurllajk*

IZMERI – rozmarinë

JAMËRLLUK – veshje e sipërme, e trashë. Shembull: *hudhe një jamërlluk krahëve se është ftohtë*

KËRRTOC – person në formë të mirë fizike

LAVAC – ndërthurje në mënyrë rrethore. Shembull: *e paska ba lavac*

LLEK – i pjekur mirë; fik i mbjellur mirë

MARATE – dëshirë. Shembull: *t'i plotsoft Zoti ato marate!*

NATRRAMAQ – i lë punët zvarrë, nuk e çon një punë deri në fund

NJEN – nuk kam kohë

OKATARE – masë 1.5 litra. Shembull: *ma bjer një okatare raki*

PERËM – merak i madh. Shembull: *më ka ngelë perëm filan gjë...*

QERSATA – ullinj që thahen në pemë e bien vetë në tokë. Shembull: *kam dalë me mbledhë qersata*

ROXH – të lë pa asgjë. Shembull: *e ka qit roxh*

RRAZDAK – qafëtrashë. Shembull: *qafë rrazdak*

SARRATAJN – shi shumë i shkurtër

SHËN LLESHA – lule e bardhë aromatike e lartësive të mëdha

TALLASUM – gjendje e mirë shpirtërore

THAJPS – ka dy kuptime: thikë; biberon

UJUMIBUHUR – dita e 15 gushtit; sipas legjendës, nëse lihesh jashtë atë ditë, lëkura bëhet me pulla

VDAR – humb mendjen. Shembull: *jam tu vdar mendjen…*

XAJ – nxirë. Shembull: *hooo, ç'paska nxirë dielli*

XHEBELEG – shkak për sherr. Shembull: *mos më rreh xhebeleg kot…*

YST – shumë lekësh në rastet e ndërrimit kokë më kokë

ZGAFNU – rrah me shpatulla

ZHLLEPE – e shëndoshë, e pakujdesshme, e pambledhur
Pasi listova këto fjalë më karakteristike të fjalorit të fjalëve krutane, të përzgjedhura nga Ilir Goci, nuk më mbetet veçse të them: këto

të gjitha janë aq të veçanta, sa edhe po t'i krahasosh me fjalorin e gjuhës shqipe, ato mbeten krejt unike dhe të pashoqe.

Prandaj edhe i uroj Ilir Gocit: faleminderit për këtë thesar fjalësh të rralla të mbledhura, dhe ju, audiencës, shumë faleminderit për kënaqësinë që më dhatë, duke më dhënë mundësinë të flas në këtë promovim kaq interesant.